



## **Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve (Mbledhja Themeluese)**

Tiranë, më 6. 10. 1998

### **Akti i Themelimit**

1. FEFAD i njohur si person juridik me Vendim Gjykatë Nr. 106, i datës 03.08.1995 dhe si aksioner i FEFAD BANK, paraqet këtë Akt Themelimi:
2. FEFAD BANK është organizuar si një shoqëri tregtare e formes anonime, bazuar në Ligjin Nr.7638, të datës 18.11.1992 "Mbi Shoqëritë Tregtare", dhe në Ligjin Nr. 8075 të datës 22.02.1996 "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe në licensën dhënë FEFAD BANK nga Banka e Shqipërisë.
3. Objektivi i FEFAD BANK është të përftojë shërbime bankare të përshtatura specifikisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri. Aktivitetet e FEFAD BANK që synojnë arritjen e këtij objekti janë specifikuar në Nenin 26 të Ligjit "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë" dhe përmbajnë sa më poshtë:
  - pranim depozitash,
  - dhënie kredish,
  - marrje fondesh hua dhe shit-blerje instrumentesh të tregut të parasë, letra me vlerë të borxhit, kontrata të së ardhmes dhe opcione dhe instrumenta të normave të interesit,
  - përfitim shërbime pagesash dhe për arkëtim,
  - emetim dhe administrim mjete pagesash, përfshirë letra krediti dhe kambiale,
  - dhënie garancish, blerje të të arkëtueshmeve dhe pretendimeve të tjera.
4. FEFAD BANK është themeluar si një shoqëri tregtare e formes anonime për të kryer aktivitetet e sipërhënuara për një periudhë të pacaktuar kohe.
5. Bordi i Drejtorëve të FEFAD BANK si një shoqëri tregtare e formes anonime përbëhet nga:
  1. Dr. Manfred Schüller
  2. Znj. Milbana Tole
  3. Znj. Albina Karamitro

4. Z. Jürgen Trede

5. Z. Arnim Kraemer



FEFAD BANK do të veprojë konform Ligjit në fuqi, këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Bankës.

Dr. Manfred Schüler

Znj. Milbana Tole

Znj. Albina Karamitro

Z. Jürgen Trede

Z. Arnim Kraemer